



06 -11- 2009

Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariat@kqz-ks.org www.kqz-ks.org

Prishtinë / Priština  
nr. lbr. 1068-09

*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenet 63.4, 63.11 si dhe 83.1, 83.2, dhe 83.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 05.11.2009 nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për caktimin e Qendrave të reja/alternative të Votimit për Zgjedhjet Komunale të 15 nëntorit 2009**

- I. Miratohen rekomandimet e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve – KKZ për caktimin e Qendrave Alternative të Votimit, përkatësisht ndërrimin e lokacioneve/adresave të QV-ve të publikuara nga KQZ-ja me 30.07.2009 për Zgjedhjet Lokale të 15 nëntorit 2009 si dhe Raundin e II-të të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave.
- II. Regjistri i QV-ve të reja/alternative sipas Komunave përkatëse të Republikës së Kosovës nga pika I, i është bashkangjitur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- III. Sekretariati i KQZ-së përmes KKZ-ve do të njoftojë votuesit për ndryshimin e lokacioneve të QV-ve përmes burimeve në dispozicion të mediave lokale, dhe vendos lajmërimi në lokacionin origjinal të QV-së duke këshilluar votuesit për lokacionin e ri të QV-së.
- IV. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së që përmes Komisioneve Komunale përkatëse të Zgjedhjeve të ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

*Për shkak të indikacioneve dhe informatave nga KKZ-të e disa Komunave të Republikës së Kosovës veçmas të atyre të banuara me shumicë nga komuniteti serb, se një numër i caktuar i QV-ve mund të mos hapen në Ditën e Zgjedhjeve me 15 nëntor 2009, dhe me qëllim që votuesve të caktuar nëpër këto QV t'iu mundësohet e drejta e votimit në këto zgjedhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pranuar udhëzimet e KKZ-ve përkatëse për ndërrimin përkatësisht ndryshimin e lokacioneve të QV-ve aktuale me QV- të e propozuara.*

Prishtinë, 05.11.2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve